



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council

KPK/Nr. 602/2022
Datë: 14 Prill 2022

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), në bazë të nenit 110 pika 2 Kushtetutës së Republikës së Kosovës në pajtim me nenin 7 paragrafi 1 pika 11 dhe nenit 34 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 13 dhe 14 Ligjit Nr. 06/L - 057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Prokurorëve dhe si dhe nenit 19 dhe 20 të Rregullores Nr. 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve, sipas Marrëveshjes vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore AD.Nr.01/20222, të datës 04 Prill 2022, duke vendosur në çështjen disiplinore ndaj prokurores Stojanka Kasalovic, prokurore në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, gjatë shqyrtimit të mbajtur me datë 14 Prill 2022, në seancën e këshillimit e votimit, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** - si e bazuar Marrëveshja vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore AD.nr.01/2022, e datës 04 Prill 2022, e lidhur me prokuroren Stojanka Kasalovic, prokurore në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, Departamenti i Përgjithshëm.
- II. **Vërtetohet** se prokurorja Stojanka Kasalovic, prokurore në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, ka vepruar në kundërshtim me Kodin e Etikes dhe Sjelljes Profesionale për Prokurorë dhe nenin 6 par.2 pikat 2.1 dhe 2.5 i Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.
- III. Prokurores Stojanka Kasalovic, i shqiptohet sanksioni disiplinor, **Vërejtje publike me shkrim**, sipas nenit 7. par.1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Ar sy e t i m

Më datë 11 Janar 2022, Këshilli Prokurorial i Kosovës, nga Autoriteti Kompetent, ka pranuar propozimin për fillimin e procedurës hetimore disiplinore ndaj Prokurores Stojanka Kasalovic, Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L - 057 për Përgjegjësin Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 8 të Rregullores Nr.05/2019 për Procedurën Disiplinore të Prokurorëve.

Autoriteti Kompetent i ka rekomanduar Këshillit Prokurorial të Kosovës, që Prokurores Stojanka Kasalovic t'i shqiptohet sanksioni disiplinor "Vërejtje publike me shkrim" në përputhje me nenin 7, paragrafi 1, pika 2.1 të Ligjit të lartcekur, lidhur me lëshimin e veprimeve procedurale për rastin e dhunës në familje nga neni, 248 i KPRK-së, ndaj viktimës L.Q. nga fshati [REDAKTUAR] [REDAKTUAR], e cili rast rezultoi me fatalitet nga se me datë 05.01.2022 u vra nga bashkëshorti i saj S.Q.

Këshilli Prokurorial i Kosovës me vendimin me numër KPK/Nr.127/2022, të datës 12 janar 2022, ka themeluar Panelin Hetimor për hetimin e rastit disiplinor, AD.nr.01/2022, ndaj prokurores Stojanka Kasalovic, Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, për sigurimin e fakteve dhe mbledhjen e provave lidhur me shkeljen e supozuar disiplinore.

Paneli hetimor me qëllim të vërtetimit të plotë të fakteve dhe provave gjatë hetimit disiplinor ka dëgjuar subjektin e hetimit, ka dëgjuar dëshmitarët: zyrtaren policore të rastit dhe mbrojtësen e viktimave të ZMNV, ka siguruar deklaratën e zyrtarit policor, i cili ishte person kontaktues me prokuroren për shkak të njohjes së gjuhës serbe, të dhënë në Inspektoratin Policor të Kosovës. Gjithashtu është siguruar informata për transferimin e përkohshëm - degradimi i zyrtares policore me punë dhe detyra tjera në një region tjetër nga [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR]. Paneli Hetimor gjeti se prokurorja Stojanka Kasalovic ka qenë kujdestare në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë, me datë 01.01.2022, kur është thirrur nga zyrtari policor i stacionit policor S [REDAKTUAR] i cili e kishte raportuar një zënkë në një familje, ku djali i cili ishte i rritur e kishte raportuar babain sepse ai e kishte larguar nënën nga shtëpia për shkaqe xhelozie. Me qenë se nuk kishte pasur dhunë fizike, s'kishte pasur recidivizëm dhe djali i viktimës kishte garantuar për sigurinë e nënës, prokurorja Kasalovic nuk kishte marrë aktvendim për ndalim, kishte udhëzuar që rasti të hapet për dhunë në familje, por në procedurë të rregullt dhe të informohet mbrojtësi i viktimave, por që më nuk është interesuar për rrjedhën e rastit. Prokurorja e ka pranuar fajësinë gjatë seancës dëgjimore, të njëjtën e ka paraqitur edhe përmes deklaratës faktike. Prokurorja Kasalovic ndien keqardhje, nuk është e interesuar ta fajësojë askënd tjetër dhe pranon se ka pasur neglizhencë nga ana e saj sepse do t' duhej të kishte komunikuar më shumë me policinë, në fakt për të detyruar policinë ta informonin sërish për rastin dhe të

kontaktonin me mbrojtësin e viktimave në mënyrë që të vazhdonin të punonin së bashku. Në mungesë të këtyre veprimeve prokurorja Kasalovic është përfshirë në sjellje të cilat e kanë dëmtuar reputacionin e prokurorit të shtetit dhe kanë dëmtuar besimin e publikut në profesionalizmin, paanshmërinë ose besueshmërinë në Prokurorinë e Shtetit, kur nga neglizhenca nuk i ka ushtruar funksionet e saj prokuroriale, kur nuk i ka ndërmarrë masat e nevojshme për mbrojtjen e viktimës, konkretisht nuk është interesuar nëse viktimës iu ka siguruar urdhri mbrojtës apo jo pavarësisht se përgjegjësia ka qenë e shpërndarë sepse vikendeve dhe ditëve të festave urdhri i përkohshëm emergjent lëshohet nga Koordinatori Regjional i Policisë. Në rastin konkret në bazë të fakteve dhe provave të elaboruara më lartë, **Paneli Hetimor** ka vërtetuar se pretendimet e paraqitura në kërkesën e Autoritetit Kompetent për inicimin e procedurës disiplinore dhe propozimin për shqiptimin e masës disiplinore vërejtje publike me shkrim, janë të bazuara në prova dhe fakte dhe nga hetimi rezulton se janë gjetur elemente të përgjegjësisë disiplinore, që bien ndesh me dispozitat e Kodit të Etikës dhe Sjelljes Profesionale për Prokuror gjegjësisht tek Parimi i profesionalizmit **pika a)** ku prokurori duhet të marrë parasysh të gjitha rrethanat që janë në favor dhe në dëm të të pandehurit, mbrojtjen e të drejtave ligjore të viktimave, dëshmitarëve, të dyshimtëve, të akuzuarve, personave të dënuar dhe pjesëmarrësve tjerë në procedurë, **pika c)**, ku prokurori zbaton standardet më të larta të kujdesit gjatë kryerjes së funksioneve zyrtare dhe **pika e)**, ku është theksuar se prokurori duhet që ti përcaktoj qëndrimet e tij shpejt, qartë dhe vendosmërisht, sidomos me kontaktet e tij me policinë dhe palët në procedurë dhe në kundërshtim me nenin 6 paragrafi 2 pika 2.1 e Ligjit, Nr.06/L-057 (ku prokurori nuk ndërmerr ndonjë veprim prokurorial që kërkohet me ligjin në fuqi ose nuk ushtron funksionet prokuroriale brenda afateve kohore të parapara me ligj), dhe pika 2.5 të Ligjit Nr.06/L-057 (ku prokurori nuk merr parasysh të drejtat e dëshmitarëve ose palëve të dëmtuara, veçanërisht për të marrë masa për të mbrojtur jetën, sigurinë dhe privatësinë e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi).

Paneli Hetimor, për lëndën disiplinore AD.nr.01/2022, me datë 04 prill 2022, i ka paraqitur Këshillit Prokurorial të Kosovës Marrëveshjen vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore në mes të Panelit Hetimor dhe prokurores Stojanka Kasalovic.

Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 14.04.2022 pas shqyrtimit dhe analizimit të marrëveshjes vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore, të arritur në mes të prokurores Stojanka Kasalovic dhe Panelit Hetimor, gjeti se marrëveshja për pranimin e përgjegjësisë disiplinore është e mbështetur edhe në provat materiale të lëndës hetimore penale nr. [REDAKTUAR], ku janë bërë lëshimet procedurale për rastin.

Me këtë marrëveshje vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore të pranuar vullnetarisht edhe nga ana e prokurores Kasalovic, është vërtetuar se është kryer shkelja

disiplinore e përcaktuar në nenin 6 par.2 pika 2.1 dhe pika 2.5 e Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshilli Prokurorial i Kosovës vlerësoi se marrëveshja vullnetare për shkeljen e supozuar disiplinore e lidhur në mes të prokurores Stojanka Kasalovic dhe Panelit Hetimor, së bashku me dakordimin e tyre për llojin e sanksionit disiplinor të përcaktuar në nenin 7 par.1 pika 1.2 të Ligjit për Përgjegjësi Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, i përmbush të gjitha kushtet ligjore dhe sanksioni i propozuar nga ana e tyre është i drejtë dhe në proporcion me shkeljen disiplinore.

Nga sa u tha më lartë, Këshilli Prokurorial i Kosovës në bazë të vlerësimit të çështjes mori vendim si në dispozitiv të këtij vendimi.

Jetish Maloku
Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës



T'u dërgohet:

- z. Ismet Ujkani, Kryeprokuror i Prokurorisë Themelore në Mitrovicë;
- znj. Stojanka Kasalovic, prokurore në Prokurorinë Themelore në Mitrovicë;
- Arkivit të KPK-së;